

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama: Koha e pandëshkueshmërisë ka marrë fund, drejtësia po tregon aftësi vetëpastrimi - Informohu si ç duhet
ADRESA	https://radar.al/rama-koha-e-pandeshkueshmerise-ka-marre-fund-drejtesia-po-tregon-aftesi-vetepastrimi/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 13:14:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 13:04:56 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d3256e200199c83060a32f97a626be1f5ed76cfcebc24f9995df9f7ce325a84f
TEKSTI	22145652ba7b171347ca26e4f4fee440cde9cb0922ac3983f12827851aa5d8c4
PAMJA	93c8769dba29a391d487890913b0ad2718181d6636dc3f9581993c857c698372

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	53c844bd6357e520403a806d1aa27cbd3ce0e5efa7fb1fa584f6d3f887bc2f74
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	8943aae4786784478314ed8f36e25f0bd32ee36cc85ad3e80ac7b853175904e3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/53c844bd6357e520403a806d1aa27cbd3ce0e5efa7fb1fa584f6d3f887bc2f74

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Rama: Koha e pandëshkueshmërisë ka marrë fund, drejtësia po tregon aftësi vetëpastrimi

POLITIKE

 Demo

Rama: Koha e pandëshkueshmërisë ka marrë fund, drejtësia po tregon aftësi vetëpastrimi

SEPTEMBER 27, 2026



Kryeministri Edi Rama deklaroi se koha e pandëshkueshmërisë në Shqipëri ka marrë fund në mënyrë të pakthyeshme. Duke folur për reformën në drejtësi, Rama tha se ajo ishte një vendim politik i marrë nga ai dhe Partia Socialiste, ndërsa theksoi se sot sistemi i drejtësisë po shfaq aftësi vetëpastrimi.

Rama tha se reforma nënkuptonte dorëzimin e pushtetit mbi drejtësinë nga politika te një sistem gjyqësor i pavarur.

“Koha kur në këtë vend drejtësia ishte një derë e mbyllur sa herë trokiste e drejta dhe e hapur kur e keqja donte të ulej këmbëkryq për pazar, nuk vjen më. Nuk kthehet më koha kur pushteti politik dhe pandëshkueshmëria ishin e njëjta gjë.

Ka ikur ajo kohë sepse unë dhe PS i hymë detit me këmbë dhe morëm përsipër reformën më të thellë dhe të dhimbshme, aktin e dorëzimit të shpatës së drejtësisë nga duart e pushtetit politik në duart e drejtësisë së çliruar dhe të pavarësuar.

E bëra unë, jo se isha naiv, as se nuk e dija që do të kërkonte koka, por sepse ishte imja, jona barra e asaj sakrificë të madhe politike. Sot, për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar, është vetë sistemi që po shfaq aftësi vetëpastrimi që s’i ka pasur kurrë.

Kjo është arritje e madhe, autopsinë e së cilës nuk e negocioj me askënd. Pavarësia e drejtësisë nuk ra nga qielli, nuk e solli as koha, as SHBA dhe as Europa. Ata ndihmuan, por pa ne do të kishin bërë një Noc Rok.

Nuk e solli pavarësinë e drejtësisë sorrat e korbat që bërtasin ‘korrupsion’ dhe shikojnë SPAK-un si armë kundër meje, që i kam mundur dhe i mund në çdo zgjedhje sa herë u bie mendja se më zunë ngushtë dhe më bënë gropën.

Nuk është mundja e tyre ajo që më prish gjumin dhe as fryrja e pulëkakarisa e tyre. Kjo lidhet me çfarë po ndodh, me korrupsionin dhe drejtësinë”, tha Rama.

Postimet e reja

Rama: Koha e pandëshkueshmërisë ka...

SEPTEMBER 27, 2026

“Pisanjosët me kostum parlamentar”, Rama...

SEPTEMBER 27, 2026

“Vlora Hyseni ka hyrë në një borxh të madh moral...

SEPTEMBER 27, 2026

“SHISH u ekspozua ndaj një dëmi të madh”, Ram...

SEPTEMBER 27, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç ‘Delvina Gas’ ai...

ALERT në Slloveni për VIPA
Flips të Kosovës, kanë përmbajtje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të “Top Fruits”
të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Na ndiq

SHARE.

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Dashuri, vendime dhe mundësi të reja: Si do të shkojë e diela për secilën shenjë

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu